LIGJ
Nr.9225, datë 29.4.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE UDHËTARËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve", nënshkruar në Tiranë më 10 prill 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4232, datë 26.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE DHE UDHËTARËVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, të quajtura më poshtë Palë Kontraktuese,

me dëshirën për të favorizuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e transportit rrugor ndërmjet vendeve të tyre dhe në transit nga territoret e tyre, të frymëzuara nga parimi i liberalizimit që lidhet me transportin rrugor; mbi bazën e parimit të reciprocitetit dhe të interesit të përbashkët,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për:

1. Transportin rrugor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, në transit nëpërmjet territoreve të tyre dhe ndërmjet territorit të njërës nga Palët Kontraktuese dhe një vendi të tretë.

2. Udhëtimin e mjeteve bosh në lidhje me transportin e përmendur më lart.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga angazhime të tjera ndërkombëtare të Palëve Kontraktuese, si dhe nuk ndikon ligjin e Bashkimit Europian apo marrëveshjet ndërmjet Bashkimit Europian dhe shteteve joanëtare.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Me termin “transportues” nënkuptojmë një person fizik ose juridik të regjistruar në njërën nga Palët Kontraktuese, i cili ka të drejtën të kryejë transport rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin e tij.

2. Me termin “mjet”nënkuptojmë:

- për transportin e mallrave: një mjet motorik ose një kombinim i mjeteve nga i cili të paktën mjeti motorik është i regjistruar në njërën nga Palët Kontraktuese dhe i cili përdoret dhe është i licencuar vetëm për transportin e mallrave;

- për transportin e udhëtarëve: çdo automjet i regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese, i cili si rrjedhojë e ndërtimit dhe pajisjeve të tij, është i përshtatshëm për të transportuar më shumë se nëntë persona të ulur, duke përfshirë edhe shoferin.

3. Me termin “transit” nënkuptojmë transportin e udhëtarëve dhe të mallrave nga një transportues i regjistruar në një Palë Kontraktuese nëpërmjet territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

I. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

A. Qëllimi dhe përkufizime

Neni 4

Me qëllim transportin e udhëtarëve, kjo Marrëveshje do të zbatohet:

- Për të gjitha shërbimet e transportit të udhëtarëve, për të tretë ose me qira ose për llogari të vet të kryera me automjete (autobus dhe mikrobus) ndërmjet dy Palëve Kontraktuese, në transit nëpërmjet territoreve të tyre dhe nëpërmjet territorit të njërës nga Palët Kontraktuese dhe një vendi të tretë.

- Për udhëtimet bosh të mjeteve në lidhje me këto shërbime.

- Me termin “transport udhëtarësh për llogari të vet” nënkuptojmë transportet e kryera nga një subjekt për punonjësit e tij ose nga një shoqatë jofitimprurëse për anëtarët e saj në lidhje me objektivat e saj socialë duke siguruar që:

a) aktiviteti i transportit të jetë një aktivitet plotësues i këtij subjekti ose shoqate;

b) mjetet e përdorura janë pronë e këtij subjekti ose shoqate ose janë siguruar mbi terma të mëvonshëm nga ata ose janë subjekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe janë drejtur nga një anëtar i stafit të subjektit ose shoqatës.

Neni 5

Për qëllimin e transportit të udhëtarëve:

1. Me “Shërbime të rregullta” nënkuptojmë shërbimet që sigurojnë transportin e udhëtarëve sipas një frekuence të caktuar dhe itinerari udhëtimi të përcaktuar më parë, ku zbriten dhe merren udhëtarë nëpër pika vendqëndrimi të parashikuara. Shërbimet e rregullta mund të jenë subjekt i detyrimit të respektimit të tarifave dhe orarëve të caktuar më parë.

2. Me “Shërbime vajtje-ardhje” nënkuptojmë shërbime të cilat me anën e udhëtimeve të përsëritura vajtje dhe ardhje kryejnë transportin e grupeve të udhëtarëve të formuara paraprakisht, nga një vend i vetëm nisjeje në një destinacion të vetëm, të vendosura respektivisht në të dy Palët Kontraktuese. Çdo grup i përbërë nga udhëtarët që bëjnë udhëtimin e vajtjes do të kthehet në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshëm.

a) gjatë shërbimeve vajtje-ardhje asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbritet gjatë udhëtimit.

b) udhëtimi i parë në ardhje dhe i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje do të bëhet bosh.

c) shërbimet e rregullta dhe shërbimet vajtje-ardhje dhe kushtet në lidhje me kryerjen e tyre duhet të vendosen mbi bazën e një marrëveshjeje të përbashkët të autoriteteve kompetente ose direkt, ose mbi bazën e konkluzioneve të marra nga Komiteti i Përbashkët, i cili është vendosur në nenin 14 të

kësaj Marrëveshjeje.

3.”Shërbimet e rastit” janë:

a) udhëtime me dyer të mbyllura që nënkupton shërbimet ku i njëjti automjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë udhëtimit dhe për t'i kthyer ata në vendin e nisjes, i cili është vendi i regjistrimit të automjetit;

b) shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje me udhëtarë dhe udhëtimin në kthim bosh;

c) shërbimet që bëjnë udhëtimin në vajtje bosh dhe kthimin me udhëtarë, të marrë në të njëjtën pikë të vendit ku automjeti nuk është i regjistruar, me kusht që udhëtarët:

1.të përbëjnë një grup të formuar më parë nën një kontratë transporti e përfunduar përpara mbërritjes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë, ose

2. janë dërguar paraprakisht nga i njëjti transportues sipas kushteve të paragrafit 3 rasti b dhe duke siguruar që ata janë marrë përsëri dhe janë kthyer në territorin e vendit ku është regjistruar operatori i transportit;

3. janë ftuar për të udhëtuar në territorin e vendit ku është regjistruar operatori i transportit, kostoja e transportit mbulohet nga personi që ka lëshuar ftesën;

d) çdo shërbim tjetër që nuk përmendet në nënparagrafët e mësipërm.

B. Pranimi në treg

Neni 6

1. Shërbimet e rastit që përmenden në nenin 5 paragrafi 3 (a) deri tek (c), do të përjashtohen nga nevoja për leje transporti në territorin e Palës Kontraktuese, ku mjeti nuk është i regjistruar.

2. Shërbimet e rastit duhet të kryhen të shoqëruara nga një dokument kontrolli.

3. Dokumenti i kontrollit përbëhet nga një fletudhëtimi.

4. Fleta e udhëtimit duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin kryesor;

c) transportuesin (it) e përfshirë;

e) listën e plotë të udhëtarëve.

Në rastin e paragrafit 3c (1) të nenit 5, do të kërkohet një kopje e kontratës së transportit.

Në rastin e paragrafit 3c (2) të nenit 5 do të kërkohet dokumenti që shoqëron automjetin gjatë udhëtimit në vajtje plot dhe udhëtimit në kthim bosh.

Në rastin e paragrafit 3/c (3) të nenit 5, do të kërkohet ftesa ose një kopje e saj.

5. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, ku është regjistruar mjeti ose organet e caktuara prej këtyre autoriteteve duhet të lëshojnë blloqet e fletudhëtimeve.

6. Shërbimet e rastit referuar në nenin 5 paragrafi 3/d, mund të kryhen vetëm mbi bazën e licencave të vlefshme. Numri dhe tipi i licencave duhet të vendoset nga Komiteti i Përbashkët, referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

7. Në transportin transit, asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të lihet gjatë udhëtimit, përveç rastit kur Palët Kontraktuese vendosin ndryshe nëpërmjet Komitetit të Përbashkët të nenit 14.

8. Nuk duhet leje për zëvendësimin e ndonjë autobusi me defekt, si dhe për udhëtimet e automjeteve bosh, të cilët do të kryejnë transportin sipas nenit 4 të mësipërm.

9. Transporti i udhëtarëve për llogari të vet është subjekt i lejeve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

1. Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje janë subjekt i autorizimeve.

2. Autorizimet do të lëshohen në emër të subjektit të transportit. Ato nuk mund t’i transferohen nga subjekti i transportit palëve të treta. Megjithatë, transportuesi i cili ka marrë autorizimin, mund të kryejë shërbimin (shërbimet) nëpërmjet një nënkontraktori.

3. Periudha e vlefshmërisë së një autorizimi nuk duhet të kalojë 5 (pesë) vjet për shërbimet e rregullta dhe një vit për shërbimet vajtje-ardhje.

4. Autorizimet duhet të specifikojnë treguesit e mëposhtëm:

a) llojin e shërbimeve;

b) itinerarin e shërbimit, duke dhënë në mënyrë të veçantë vendin e nisjes dhe vendin e mbërritjes, si dhe pikat e kalimit kufitar;

c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit;

d) për shërbimet e rregullta, ndalesat dhe orarët.

5. Kërkesat për autorizime do të paraqiten në autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese ku është regjistruar mjeti, i cili mund ta pranojë atë ose jo. Në rast se nuk ka vërejtje për kërkesën, autoriteti i lartpërmendur do t'ia komunikojë këtë autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese. Nëse ky i fundit bie dakord, atëherë secili kompetent lëshon autorizimin për atë pjesë të itinerarit që i përket territorit të tij.

6. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga rregullat kombëtare, si dhe një përshkrim të linjës që përmban ndalesat dhe kilometrat e autobusit të shënuara qartë. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojnë nga transportuesit çdo të dhënë përkatëse që ata e konsiderojnë të nevojshme.

7. Gjatë udhëtimit një kopje e autorizimit, e noteruar nga autoriteti zyrtar që e ka lëshuar ose origjinali i tij duhet të jenë në mjet.

8. Autorizimet duhet të jenë konform modeleve të rëna dakord nga Komiteti i Përbashkët, të përmendura në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

9. Shërbimet e rregullta në transportin transit kryhen me autorizime, të dhëna prej vendit, territori i së cilës do të kalonte transit, pas një kërkese me shkrim me gjithë anekset e nevojshme që i bëhen asaj nga vendi që ka dhënë autorizimin për shërbim të rregullt. Vlefshmëria e tyre do të jetë nga 1-5 vjet dhe do të lëshohen pa pagesë.

10. Shërbimet e rregullta ndërmjet dy vendeve ose në transit nëpërmjet territoreve të tyre duhet të aprovohen bashkërisht nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

Neni 8

Në rastin e shërbimeve të rastit, udhëtimi transit përmes territorit të një Pale Kontraktuese që kryhet nga mjeti i regjistruar në Palën tjetër, përjashtohet nga çdo lloj autorizimi.

Neni 9

Një shërbim i rregullt quhet i miratuar dhe mund të fillojë operimin menjëherë sapo autoritetet përgjegjëse të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë licencat e veçanta me të gjitha anekset e nevojshme.

II.TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 10

1. Transportuesit e regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese lejohen të kryejnë transport ndërkombëtar rrugor mallrash, për të tretë ose me qira ndërmjet dy Palëve Kontraktuese (transport bilateral), si dhe transport përmes territoreve të tyre për në vende të treta (transporti transit), duke përdorur një leje të lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Përsa i përket transportit rrugor të mallrave që realizohet nga transportues të një Pale Kontraktuese, nisur nga ose në drejtim të territorit të Palës tjetër Kontraktuese dhe nisur nga ose në drejtim të një vendi të tretë (transportet trekëndore) duhet të lëshohet një leje speciale nga Pala Kontraktuese nga e cila ose drejt së cilës kryhet transporti.

3. Këto leje speciale mund të përdoren vetëm nga transportuesit në emër të të cilit janë lëshuar dhe nuk janë të transferueshme.

Neni 11

Lloji dhe numri i lejeve, të përmendura në nenin 10, do të përcaktohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese direkt ose në bazë të konkluzioneve të adoptuara nga Komiteti i

Përbashkët sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Në bazë të nenit 10 paragrafit 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë çdo vit lejet e kërkuara nëpërmjet kanaleve diplomatike ose nëpërmjet procedurës së vendosur nga Komiteti i Përbashkët i përmendur në nenin 14.

Neni 13

Ndryshe nga dispozitat e nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje, lejet nuk janë të detyrueshme në rastet e mëposhtme:

1. Transporti i mallrave me mjete motorike, pesha totale e ngarkesës së lejueshme (TPLW) e të cilave, duke përfshirë edhe trailerat, nuk i kalon 6 tonët, ose kur ngarkesa e lejueshme, duke përfshirë edhe trailerat, nuk i kalon 3.5 tonët.
2. Transporti i mallrave mbi një bazë të rastësishme, për në ose nga aeroporti, në rastet kur shërbimet janë devijuar.
3. Transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose janë prishur dhe lëvizja e mjeteve për riparimin e dëmeve.
4. Udhëtimet pa ngarkesë të një mjeti mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet, i cili ka pasur dëmtime në një vend tjetër, si dhe kthimi pas riparimit të mjetit të dëmtuar.
5. Transporti i gjësë së gjallë në mjete të ndërtuara për këtë qëllim ose të konvertuara përgjithmonë për transportin e gjësë së gjallë.
6. Transporti i pjesëve të këmbimit dhe i rezervave për anijet transoqeanike dhe për avionët.
7. Transporti i pajisjeve dhe mjeteve mjekësore të nevojshme për emergjenca, në veçanti, në rastet e katastrofave natyrore dhe nevojave humanitare.
8. Transporti për qëllime jotregtare të punimeve dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita.
9. Transporti për qëllime jotregtare i mjeteve, aksesorëve dhe kafshëve për në ose nga shfaqje teatrale, muzikore, filma sporti ose cirku, panaire ose festivale dhe ato për qëllim regjistrimi radiofonik, ose për filma ose për prodhime televizive.
10. Transporti i mallrave për qëllim të vet.
11. Transporti funeral.
12. Transporti i postës i kryer si një shërbim publik.

Përsa i përket transporteve të përmendura në këtë nen, shoferi duhet të ketë të gjitha letrat dhe dokumentet që tregojnë qartësisht që po kryhet një nga transportet e përmendura më lart.

III. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 14

Me qëllim që të rregullohen të gjitha çështjet lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të krijohet një Komitet i Përbashkët.

Ky Komitet do të përbëhet nga përfaqësues të qeverive të të dyja Palëve Kontraktuese, të cilët mund të ftojnë në mbledhje përfaqësues të industrisë së transportit rrugor.

Komiteti i Përbashkët do të mblidhet një herë në vit ose me kërkesë të njërës prej Palëve Kontraktuese, në mënyrë alternative në territorin e njerës prej Palëve Kontraktuese.

Axhenda e takimit duhet të paraqitet nga Pala Kontraktuese pritëse ose kërkuese, në varësi të rastit. Çdo takim do të mbyllet me hartimin dhe miratimin e një protokolli, që do të nënshkruhet prej kryetarëve të delegacioneve të të dyja Palëve Kontraktuese.

Komiteti i Përbashkët do të vendosë për qëllimin dhe, gjithashtu mbi mënyrën e shkëmbimit të të dhënave dhe të të gjitha informacioneve të tjera përkatëse.

Neni 15

Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën rreth emrave dhe adresave të autoriteteve kompetente respektive për të zbatuar Marrëveshjen aktuale. Ata do të komunikojnë çdo ndryshim mbi çështjet e mësipërme.

Neni 16

1. Mjetet të cilat janë regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese dhe që përkohësisht janë importuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për të kryer shërbime transporti në përputhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohen, në përputhje me parimin e reciprocitetit, nga taksat mbi automjetet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Marrëveshjeje nuk aplikohen për taksat të lidhura me përdorimin e autostradave, urave dhe infrastrukturave të tjera, të cilat do të vendosen mbi bazën e principit të jodiskriminimit.

3. Në transportet e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje, importimi i përkohshëm i mjeteve të një Pale Kontraktuese në Palën tjetër Kontraktuese përjashtohet nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrime të tjera.

4. Karburanti për mjetet, i transportuar në depozita normale, karburanti i vendosur nga prodhuesi për këtë qëllim, si dhe vajrat lubrifikante të transportuara në mjete vetëm për qëllim të operimit të tyre, do të përjashtohen nga detyrimet, taksat dhe detyrimet e tjera të vendosura nga Pala Kontraktuese.

5. Pjesët e ndërrimit dhe veglat përkohësisht të importuara për riparimin e një mjeti të dëmtuar gjatë kryerjes së një transporti ndërkombëtar rrugor do të përjashtohen nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrimet e tjera në kohën e importimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të shprehura në dispozitat e saj përsa i përket importimit të këtyre mallrave. Pjesët e ndërrimit të cilat janë ndërruar duhet të rieksportohen ose të shkatërrohen nën kontrollin e autoriteteve kompetente doganore të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 17

Transportuesit e një Pale Kontraktuese dhe personeli i mjeteve të tyre, kur hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi të atij vendi.

Neni 18
Siguracioni

Mjetet e Palëve Kontraktuese që kryejnë transport ndërkombëtar duhet të jenë pajisur me siguracion si për vendet e destinacionit, ashtu edhe për vendet transit.

Neni 19
Kabotazhi

Kryerja e shërbimeve të kabotazhit si për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave është i ndaluar.

Neni 20
Kontrolli doganor dhe shëndetësor

Dispozitat e konventave ndërkombëtare të miratuara prej Palëve Kontraktuese zbatohen për kontrollin doganor e shëndetësor në pikat transite të kufirit.

Kontrolli i përmendur kryhet, nëse është e mundur me përparësi, në rastet e transportit të pacientëve, kafshëve dhe mallrave që prishen shpejt.

Neni 21

Kontrolli teknik i mjetit

Çdo mjet i Palëve Kontraktuese që kryejnë transport dypalësh ose transport transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese duhet të jetë i pajisur nga autoritetet shtetërore me një certifikatë teknike të vlefshme.

Çdo mjet i Palës Kontraktuese që kryen transport bilateral ose transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe transporton mallra të rrezikshme duhet të ketë të gjitha dokumentet e parashikuara nga konventa ADR.

Neni 22

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të letrave që vërtetojnë plotësimin e kërkesave ligjore respektive të Palëve Kontraktuese. Ajo do të qëndrojë në fuqi për një vit. Pas kësaj ajo do të shtyhet automatikisht për periudha të tjera njëvjeçare, në qoftë se njëra nga Palët Kontraktuese nuk njofton tjetrën, gjashtë muaj përpara mbarimit të datës, për vendimin e saj për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 10.4.2003 në tri kopje origjinale në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, të cilat janë të barasvlefshme.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshje në interpretim, teksti anglisht do të mbizotërojë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar plotësisht kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.